

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6711  
E mërkurë, 21 shtator 2022  
çmimi 0.40 €

Krasniqi hollësisht  
paraqet pesë masat për  
dalje nga kriza  
ekonomike | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## NATO-ja E GATSHME TË DËRGOJË MË SHUMË TRUPA NË KOSOVË NË RAST TË TENSIONEVE TË REJA | FAQE 4-5



"Ne jemi vigjilentë dhe të gatshëm të veprimë nëse kemi rritje të tensioneve, mirëpo edhe mund ta rritim numrin e forcave rezervë. Mund ta marrim këtë vendim brenda një kohe të

shkurtër", ka thënë zëvendëskomandanti i misionit të NATO-s në Kosovë (KFOR), Luca Piperni, para gazetarëve në selinë e KFOR-it në Prishtinë

## KOSOVA DHE SHQIPËRIA NËNSHKRUAJNË MEMORANDUM MES PARLAMENTEVE | FAQE 3



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

PROPOZIMI GJERMANO-FRANCEZ,  
I PËRAFËRT ME KËRKESAT  
E ALEKSANDËR VUÇIQT | FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

### AKTUALE



GJUKANOVIQI REFUZON  
LLEKIQIN SI MANDATAR, KËRKON  
ZGJEDHJE TË REJA | F. 2

PRISHTINA MË 22-23 TETOR,  
NIKOQIRE E FORUMIT  
NDËRKOMBËTAR PËR GRATË,  
PAQEN DHE SIGURINË | F. 3

NGARKESA E GJYKATAVE ME LËNDË  
CIVILE SI PASOJË E KONTRATAVE  
KOLEKTIVE | F. 5

### EKONOMI



PBB-JA NË KOSOVË ARRIN NË  
RRETH 8 MILIARDË EURO | F. 8

AZEMI PARAQET NJË KOMPANI  
AMERIKANE, THOTË SE DO TË  
INVESTOJË 800 MILIONË EURO | F. 8

### SPORT



KOSOVA KA MUNGESA, POR GIRESE  
PRET PARAQITJE TË MIRA | F. 10

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Krasniqi hollësisht paraqet pesë masat për dalje nga kriza ekonomike

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, i ka paraqitur të martën hollësisht pesë masat e propozuara nga ai që do të ndikojnë në përballimin e qytetarëve me gjendjen e rëndë ekonomike në të cilën po kalon Kosova.

Lideri i opozitës ka publikuar në "Facebook" pesë masat e hollësishtme, me shifra konkrete se si do të ndikojnë në ndihmën e qytetarëve të Kosovës. Deri tani Qeveria e Kosovës nuk ka pasur ndonjë reagim nëse këto propozime të kryetarit të PDK-së, Memli Krasniqi, do ta marrin mbështetjen e pushtetit. Pesë masat e propozuara nga Memli Krasniqi janë: "1. Të lirohen nga TVSH-ja të gjitha mallrat esenciale të konsumit për një periudhë gjashtë-mujore. Duke marrë parasysh se kostoja mesatare e shportës së produkteve ushqimore esenciale për një familje kosovare është rreth 422 euro,

nga kjo masë një familje mesatarisht do të përfitonte një zbritje të kostos së jetesës prej 33,76 euro në muaj. 2. Të lirohen nga akciza produktet e naftës për një periudhë gjashtë-mujore, gjë e cila do të ulë çmimin e naftës për 36 centë në litër. Duke supozuar një shpenzim mujor prej 60 litra naftë në muaj për një familje, atëherë përfitimi direkt mesatar mujor nga kjo masë do të ishte 21.6 euro në muaj. 3. Të lirohet nga TVSH-ja konsumi i energjisë elektrike për një periudhë gjashtë-mujore dhe të subvencionohen me 25% faturat e atyre që konsumojnë deri në 1200 kwh. Duke marrë për bazë një faturë prej 90 euro që rezultojnë nga një konsum i tillë, atëherë vlerësojmë se përfitimi mujor nga kjo masë për një familje do të jetë 27.9 euro. 4. Të rriten pagat, pensionet dhe ndihmat sociale për të paktën aq sa është norma mesatare e inflacionit



(rreth 15%). Nëse e marrim për bazë pagën mesatare prej 484 euro sa ka qenë në vitin 2021, atëherë përfitimi mujor nga kjo

masë për punonjësit do të ishte rreth 72.6 euro në muaj. 5. Të lejohet tërheqja deri në 30% e kursimeve pensionale dhe të

rimbursohet gradualisht shuma e tërhequr për kontribuuesit që kanë më pak se 10,000 euro në llogaritë e Trusti-t".

## Gjukanoviqi refuzon Llekiqin si mandatar, kërkon zgjedhje të reja

PODGORICË, 20 SHTATOR - Presidenti i Malit të Zi, Milo Gjukanoviqi, tha se nuk mund ta pranojë propozimin që Miodrag Llekiqi të jetë mandatar për formimin e qeverisë së re të këtij vendi sepse, sipas tij, nuk janë plotësuar kushtet e nevojshme. Gjukanoviqi, në të njëjtën kohë, propozoi shkurtimin e mandatit të përbërjes aktuale të Kuvendit të Malit të Zi, për t'iu hapur rrugë zgjedhjeve të reja. "Nuk kam pasur përshtypjen se ekziston një shumicë e qartë për formimin e një qeverie, që do t'u ofronte zgjidhje problemeve shumë të vështira në planin financiar, ekonomik, juridik, institucional dhe politik", tha Gjukanoviqi. Partitë që fituan shumicën në zgjedhjet parlamentare në Mal të Zi, në gusht të vitit 2020 - Fronti Demokratik pro-serb,



Demokratët dhe URA - ranë dakord të hënën vonë që Llekiqi të jetë mandatar për përbërjen e qeverisë së re. Por, ato nuk i dorëzuan nënshkrimet e 41 deputetëve - sa kanë bashkërisht në Kuvendin prej 81 ulësesh. Gjukanoviqi përmendi në mënyrë të veçantë aspektin e sigurisë, duke thënë se kriza aktuale në Evropë, e shkaktuar nga agresioni i Rusisë kundër Ukrainës, ka implikime për sigurinë e Ballkanit Perëndimor. Gjukanoviqi tha se në rrethana të tilla propozimi për Llekiqin tregon "qëllimin për të blerë më shumë kohë në negociatat për ndarjen e portofoleve në qeveri", derisa shteti, në anën tjetër, "do të shembet edhe më shumë". Gjukanoviqi tha se zgjidhja më optimale e kësaj situatë politike është shkurtimi i mandatit të

Kuvendit, që do ta hapte mundësinë e organizimit të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Mali i Zi është me qeveri teknike qysh në fund të gushtit. Mocioni i mosbesimit ndaj qeverisë së kryeministrit Dritan Abazoviqi u votua në Kuvend pasi Abazoviqi nënshkroi një marrëveshje kontroverze me Kishën Ortodokse Serbe. Abazoviqi, udhëheqës i partisë pro-evropiane URA, ka marrë detyrën në fund të prillit. Partia e tij bashkë me Frontin Demokratik dhe Demokratët kanë formuar një përbërje tjetër qeveritare pas zgjedhjeve të gushtit 2020. Por, partnerët e atij koalicioni janë prishur - për shkak të qëndrimeve të kundërta për disa çështje - gjë që ka çuar pastaj në zgjedhjen e Abazoviqit.

## Oiproja shpëton qindra migrantë të bllokuar në det

NIKOSIA, 20 SHTATOR - Autoritetet në Qipro kanë shpëtuar qindra migrantë mbremjen e së hënës dhe në orët e para të së martës. Migrantët ishin larguar nga Libani dhe ishin bllokuar në det në dy incidente të ndara, thanë zyrtarët.

Autoritetet përdorën mjete ajrore dhe lundruese për t'i shpëtuar migrantët rreth 203 kilometra në perëndim të ishullit të hënës pas raportimeve se një anije me

mbi 300 persona në bord kishte vështirësi.

Edhe anijet komerciale u mobilizuan për t'i transferuar migrantët, tha Qendra e Përbashkët për Shpëtim e Qipros përmes një njoftimi për medie.

Disa orë më vonë një anije tjetër raportoi se ndodhet në vështirësi në jug të Qipros. Në bordin e saj gjendeshin 177 persona. "Në anije kishte filluar të depëronte uji dhe ata

kërkuan ndihmë", tha zëvendëskomandanti i Qendrës së Përbashkët për Shpëtim, Andreas Zacharia.

Ai tha se të gjithë migrantët janë dërguar në breg.

Autoritetet nuk treguan çfarë nacionaliteti kanë migrantët. Megjithatë, Libani, prej nga ishin nisur anijet që po transportonin migrantët, është shndërruar në pikënisjen e rrugëtimit të shumë migrantëve që synojnë të arrijnë në Evropë.



## Kurti thotë se do të themelojë zyrë për Luginën, e harron zyrën e themeluar nga Hoti

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Kryeministri Albin Kurti ka paralajmëruar një ditë më parë se në funksion të përmirësimit të gjendjes së shqiptarëve në Luginë për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të tyre, do ta themelojë Zyrën për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Por ndaj këtij paralajmërimi ka reaguar ish-

zëvendëskryeministri Driton Selmanaj, i cili thotë se më 28 shtator 2020 Qeveria e Kosovës, e cila drejtohej në atë kohë nga Avdullah Hoti ka votuar në mbledhjen e saj për themelimin e kësaj zyre. "Adoleshenca politike dhe logjika primitive e disa politikanëve ballkanas i dërgon të tillët në përfundimet se historia e një vendi fillon me ta dhe nga ta. Albin Kurti promovon si ide dhe vendime

të reja diçka që para dy vjetësh qeveria Hoti i ka marrë. Me qëllim të zbatimit të këtij vendimi më 13 janar 2021 qeveria Hoti ka miratuar edhe planin e punës për këtë zyrë, ku janë përcaktuar dhe detyrat konkrete për ministrinë e caktuara", ka shkruar në "Facebook" Selmanaj. Kurti ka thënë se kjo zyrë do të koordinohet nga Ardita Sinani, të cilën e ka emëruar këshilltare politike.



## NATO-ja e gatshme të dërgojë më shumë trupa në Kosovë në rast të tensioneve të reja

"Ne jemi vigjilentë dhe të gatshëm të veprimë nëse kemi rritje të tensioneve, mirëpo edhe mund ta rritim numrin e forcave rezervë. Mund ta marrim këtë vendim brenda një kohe të shkurtër", ka thënë zëvendëskomandanti i misionit të NATO-s në Kosovë (KFOR), Luca Piperni, para gazetarëve në selinë e KFOR-it në Prishtinë

PRISHTINË, 20 SHTATOR - NATO-ja është e gatshme ta rrisë numrin e trupave në Kosovë, nëse ka rritje të tensioneve në mesin e minoritetit serb, lidhur me vendimin e Qeverisë së Kosovës për regjistrimin e makinave me targa RKS - Republika e Kosovës. "Ne jemi vigjilentë dhe të gatshëm të veprimë nëse kemi rritje të tensioneve, mirëpo edhe mund ta rrisim numrin e forcave rezervë. Mund ta marrim këtë vendim

brenda një kohe të shkurtër", ka thënë zëvendëskomandanti i misionit të NATO-s në Kosovë (KFOR), Luca Piperni. Ai i ka bërë këto deklarata para gazetarëve në selinë e KFOR-it në Prishtinë të martën. Situata në veri të Kosovës është tensionuar më 31 korrik, një ditë para se Qeveria e Kosovës ta niste zbatimin e vendimit për dokumentet për hyrje/dalje dhe regjistrimin e targave të makinave

në RKS, raporton REL. Serbët lokalë kanë vendosur barrkada në rrugët që çojnë në pikëkalimet kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë - Jarinjë dhe Bërnjak. Për shkak të tensioneve, dhe me kërkesë të mekanizmave ndërkombëtarë, Qeveria e Kosovës e pati shtyrë zbatimin e vendimit për një muaj dhe barrkadat më pas janë hequr. Ndërkohë palët janë pajtuar për çështjen e dokumenteve për hyrje/dalje, ndërsa vendimi për regjistrim të makinave ka hyrë në fuqi më 1 shtator dhe do të zgjasë deri më 31 tetor. Autoritetet në Kosovë nuk kanë ofruar hollësi se si do të veprimë pas skadimit të këtij afati. Në Kosovë vlerësohet se janë rreth

10 000 makina me targa të qyteteve të Kosovës - kryesisht KM (Mitrovicë e Kosovës) të cilat i lëshon Serbia. Kosova i konsideron këto targa ilegale, meqë Prishtina dhe Beogradi kanë marrëveshje për liri të lëvizjes prej vitit 2011. Piperni ka thënë se situata aktualisht është e qetë, mirëpo e brishtë, andaj NATO-ja nuk përjashton mundësinë e tensioneve të reja, apo dhunës, kur të skadojë afati i regjistrimit të makinave më 31 tetor. "Nëse situata përkeqësohet, ne jemi gati të intervenojmë, ne jemi të gatshëm që të jemi në mes të protestuesve dhe organizatave të sigurisë. Ne kemi forca të mjaftueshme për t'u përballur me situatën. Me një numër të tillë

trupash, ne mund t'i japim fund secilit lloj të tensionit", ka thënë Piperni, duke iu referuar trupave jashtë Kosovës, që mund t'i angazhojë NATO-ja si përforsime. Autoritetet në Serbi kanë thënë se vendimet e tilla të Qeverisë së Kosovës synojnë dëbimin e serbëve nga veriu i Kosovës. Megjithatë, ato nuk kanë paraqitur prova për pretendime të tilla. Dialogu për normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë ka nisur më 2011. Palët kanë nënshkruar disa marrëveshje, por jo të gjitha janë zbatuar. Kosova insiston që dialogu të finalizohet me njohje të ndërsjellë, derisa Serbia përmend zgjidhje kompromisi.



## Prishtina më 22-23 tetor, nikoqire e Forumit Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Më 22-23 tetor 2022 Prishtina do të jetë nikoqire e Forumit Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (WPS Forum), lajmin e ka publikuar në "Facebook" presidentja Vjosa Osmani. "Ky forum do të sjellë në Kosovë liderë nga rajoni dhe bota, akademikë, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, shoqërisë civile, e personalitete përgjegjëse për zbatimin agjendës GPS, 22 vjet pas

miratimit. Me temë 'Ndërtimi i aleancave për paqe të qëndrueshme', Forumi ka për qëllim ta rrisë ndërgjegjësimin mbi nevojën për të njohur e promovuar aftësitë e grave dhe vajzave për të kontribuar në mënyrë aktive e përmbytësore në procese të paqes dhe sigurisë", ka shkruar Osmani. Ajo ka theksuar se edicioni i parë i këtij forumi i dedikohet trashëgimisë së ish-sekretares së ndjerë të ShBA-së, Madeleine

Albright. "Kënaqësi të organizojmë këtë forum në bashkëpunim me zëvendëskryeministren dhe ministren e Punëve të Jashtme, znj. Donika Gërvalla Schwarz dhe me mbështetjen e partnerëve të shumtë lokalë e ndërkombëtarë. Për të gjitha informatat rreth forumit, pjesëmarrësve e paneleve, drejtohuni te Presidenca e Republikës së Kosovës", ka shkruar presidentja Osmani.





# Kosova dhe Shqipëria nënshkruajnë memorandum mes parlamenteve

Në një adresim të përbashkët për medie në ambiente të Kuvendit të Shqipërisë, pas nënshkrimit të memorandumit, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca dhe kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Lindita Nikolla, theksuan rëndësinë e këtij dokumenti nëpërmjet të cilit synohet rritja e cilësisë së aktivitetit parlamentar në përputhje me praktikën më të mira evropiane, forcimi i bashkëpunimit midis dy kuvendeve për çështje që kanë të bëjnë me proceset e integritimit në BE, përfaqësimit në organizatat ndërkombëtare dhe çështje të tjera me interes të përbashkët

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**TRIANË, 20 SHTATOR** - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca dhe kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Lindita Nikolla, kanë nënshkruar të martën në Tiranë memorandumin e bashkëpunimit midis dy parlamenteve, i cili ka për qëllim krijimin e një kuadri të përbashkët për bashkëpunimin dhe mbështetjen midis Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në një adresim të përbashkët për medie në ambiente të Kuvendit të Shqipërisë, pas nënshkrimit të memorandumit, Konjufca dhe Nikolla theksuan rëndësinë e këtij dokumenti, nëpërmjet të cilit synohet rritja e cilësisë së aktivitetit

parlamentar në përputhje me praktikën më të mira evropiane, forcimi i bashkëpunimit midis dy kuvendeve për çështje që kanë të bëjnë me proceset e integritimit në BE, përfaqësimit në organizatat ndërkombëtare dhe çështje të tjera me interes të përbashkët.

Duke falënderuar kryetaren Nikolla për pritjen e ngrohtë, Konjufca vlerësoi kontributin dhe rolin e saj në mbrojtje dhe afirmim të interesave dhe iniciativave të Kosovës në të gjitha instancat ndërkombëtare, me theks të veçantë për lobimin lidhur me procesin e liberalizimit të vizave. "Të gjitha institucionet e shtetit shqiptar i kanë qëndruar pranë shtetit të Kosovës, sepse ne jemi dy shtete, por po aq saktë e dimë që jemi popull me një interes të përbashkët", ka thënë Konjufca.

Kreu i Kuvendit tha se bashkëpunimi dhe arritjet janë të thella, por edhe sfidat nuk janë të vogla.

Konjufca ka thënë se pas shkurtit të këtij viti bota është më e pasigurt se më parë, por njëkohësisht agresioni i papranueshëm i Rusisë mbi popullin e Ukrainës ka nxitur si kurrë më parë unitetin e botës demokratike dhe rreshtimin e fuqishëm kah vlerat e botës së lirë, duke përfshirë edhe Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës.

Duke folur për raportet me Serbinë, Konjufca ka deklaruar se Serbia e Vuçiqit nuk ka ndryshuar në drejtimin politik prej kohës së Millosheviqit, por i ka ndryshuar vetëm mjetet. Ai ka thënë se çdo shqiptar duhet ta dijë se Serbia është shumë armiqësore ndaj Republikës së Kosovës, zgjedhje kjo e elitës

politike shtetërore serbe, e cila e mohon dhe e lufton pavarësinë e Kosovës me çdo mjet që e ka në dorë.

Konjufca ka thënë se në muajt e fundit u pa se presidenti serb nuk heziton fare ta sfidojë kornizën e sigurisë në Ballkan dhe në Evropë nëpërmjet kërcënimit të Kosovës dhe dërgimit edhe të trupave të armatosura, të kontrolluara prej Serbisë, brenda territorit të Republikës së Kosovës. "Ne dëshirojmë që me Shqipërinë të jemi brenda një kornize dhe frekuencave të njëjta sa i përket gjykimit të veprimtarisë së Serbisë brenda Kosovës, sepse Republika e Kosovës nuk ka rrugë tjetër përveçse t'i mbrojtë deri në fund interesat e veta shtetërore karshi Serbisë. Ne jemi për paqe dhe dialog me Serbinë, në të njëjtën kohë nuk do të lëshojmë pe sa iu përket interesave kushtetuese nacionale dhe të panegociueshme të Republikës së Kosovës", ka theksuar Konjufca.

I pari i legjislativit tha se Kosova i gëzohet çdo arritjeje dhe suksesi të Republikës së Shqipërisë, siç ishte hapja e negociatave për anëtarësim në

Evropian. "Shqipëria dhe Kosova i përkasin të njëjtit oborr të vlerave demokratike e synimi ynë është që të bashkohemi duke qenë pjesë e Bashkimit Evropian", është shprehur Konjufca.

Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Lindita Nikolla, ka thënë se takimi me delegacionin e Kuvendit të Kosovës ishte rikonfirmim i bashkëpunimit të shkëlqyer e vëllazëror midis dy vendeve dhe kuvendeve respektive. Ajo ka thënë se bashkëpunimi intensiv dhe produktiv midis Kuvendit të Shqipërisë dhe Kuvendit të Kosovës gjatë kësaj legjislature është konkretizuar me 18 vizita pune në Prishtinë dhe Tiranë, si dhe me tryezën e kryetarëve të komisioneve parlamentare. "Bashkë me kryetarin Konjufca dhe Kryesinë e Kuvendit të Kosovës ramë dakord që shkëmbimet, vizitat dhe organizimi i tryezave të përbashkëta të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ky bashkëpunim prej ditës së sotme do të mbështetet edhe në Memorandumin e Bashkëpunimit midis Kuvendit të Shqipërisë dhe Kuvendit të

# Kamberi për thirrjet për arrestimin e tij: Po përdoren metoda të Millosheviqit

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Deputeti i vetëm shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka thënë se nuk e ka pritur që dikush do të guxonte ta kërkonte arrestimin e tij në këtë institucion shtetëror në prani të presidentit të Serbisë. Arrestimi i Kamberit, për shkak të deklaratës së tij se Kosova është shtet i pavarur, u kërkua në një seancë parlamentare nga deputetja e Partisë Socialiste të Serbisë, njëherësh nënkryetarja e Kuvendit, Snezhana Paunović. “Unë prisja që të gjithë t’i kundërshtonin qëndrimet e mia, por nuk prisja që dikush do të guxonte të kërkonte, në prani të presidentit të Republikës, në Kuvend, jo vetëm burgosjen e një deputeti, por ajo që është më e keqja dëbimin tim nga Serbia”, ka thënë Kamberi në një intervistë për Shërbimin e Ballkanit të “Radios Evropa e Lirë”.

Gjatë seancës dyditore të Kuvendit, që u mbajt javën e kaluar, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, paraqiti raportin për dialogun me Kosovën dhe iu përgjigj pyetjeve të deputetëve.

Kamberi, një prej deputetëve të paktë që haptazi nje pavarësinë e Kosovës, përfaqëson komunitetin shqiptar në Kuvendin e Serbisë.

Pasi Kamberi deklaroi në seancën plenare se Kosova është

shtet i pavarur dhe se autoritetet në Serbi duhet të bashkëpunojnë me autoritetet e Kosovës, Snezhana Paunović, deputete e Partisë Socialiste, partia e ish-liderit serb, Slobodan Millosheviq, deklaroi se Kamberi ka shkelur betimin e bërë para Kuvendit dhe Kushtetutën e Serbisë, ku thuhet se Kosova është pjesë e Serbisë. “Çfarë nuk lejohet të thuhet në Kuvendin e Serbisë - është kjo”, ka deklaruar Paunović, duke shtuar se ka bazë për arrestimin e Kamberit.

Sipas rregullores serbe, deputetët gëzojnë imunitet dhe nuk mund të ndiqen penalisht për shprehje të mendimeve apo votë të shprehur verbalisht apo me shkrim.

Shaip Kamberi tha për REL-in se e gjithë kjo ndodhi në prani të presidentit të Serbisë, i cili nuk reagoi dhe kryetarit të Kuvendit, i cili, siç tha Kamberi, obligohet sipas Rregullores së Punës dhe Ligjit për Kuvendit, të kërkojë nga deputetët që të mos përdorin metoda të tilla të frikësimit. “Në këtë lloj mjedisi politik është normale të presësh që dikush të shprehet se nuk është dakord me ju ose që ka mendim të ndryshëm politik. Mirëpo, siç ndodhi në Kuvend - një vend ku, të paktën formalisht, një deputeti i lejohet ta shprehë lirshëm mendimin e tij, siç e parashihet Ligji për Kuvendin, sigurisht se



nuk prisja që të shkonte kaq larg”, ka thënë Kamberi, duke shtuar se ky rast tregon se janë hequr maskat dhe se ata që kanë veshur kostumin demokratik po tregojnë se nuk kanë ndryshuar dhe se po mundohen t’i përdorin metodat e Millosheviqit, sidomos kur bëhet fjalë për shqiptarët. “Për mendimin tim, kjo është e keqe për demokracinë, e keqe për vendin që synim primar të politikës së jashtme e ka afrimin me Bashkimin Evropian, pra anëtarësimin në bllok”, ka thënë ai.

Kamberi ka theksuar se deklaratat e nënkryetares së

Kuvendit serb i ka parë si “gjuhë të urrejtjes”, por shtoi se duke e ditur se cilës parti i përket ajo, ato kanë qenë të pritshme. “Kjo mund të pritej nga Partia Socialiste, partia që ka përgjegjësinë më të madhe për të gjitha krimet që ndodhën në Ballkan dhe për gjithçka që ka ndodhur në Kosovë. Por, të thonë diçka të tillë në prani të presidentit të Republikës, vërtet nuk e prisja”, është shprehur ai. Sipas Kamberit, baza e politikës që kërkon që Kosova t’i kthehet Serbisë është synimi që kishte Millosheviqi, “që Kosova të jetë nën Serbi, por pa shqiptarë”.

Deputeti Kamberi tha se tani është koha që Kosova dhe Serbia të diskutojnë dhe të arrijnë një marrëveshje në përputhje me situatën reale. “Unë kërkova që presidenti Vuçiqi ta marrë përgjegjësinë e një burrështetasi, të arrijë paqe me shqiptarët dhe të punojë për prosperitetin në Ballkanin Perëndimor”, ka thënë Kamberi.

Ai ka shtuar se nëse deklaratat e tij në Kuvend konsiderohen armiqësore ndaj shtetit të Serbisë atëherë, sipas tij, shtrohet pyetja se cili është për prosperitetin në Ballkanin Perëndimor”, ka thënë Kamberi.

Edhe në të kaluarën Kamberi ka deklaruar se Kosova është shtet i pavarur dhe ka kërkuar që palët të arrijnë një marrëveshje dhe ai sërish theksoi se nuk do të tërhiqet nga këto qëndrime.

Kosova dhe Serbia që nga viti 2011 zhvillojnë dialog për normalizimin e raporteve me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian.

Të dyja palët kanë dallime sa i përket përfundimit të këtij procesi. Kosova kërkon që dialogu të përmbyllet me një marrëveshje me njohje reciproke, ndërsa Serbia kërkon një zgjidhje kompromisi. Megjithatë, zyrtarët në Beograd nuk kanë treguar se për çfarë kompromisi bëhet fjalë.

## Ngarkesa e gjykatave me lëndë civile si pasojë e kontratave kolektive

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), me përkrahje të Departamentit të Shtetit Amerikan - Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe NED-it, të martën ka mbajtur konferencë për medie, në të cilën është publikuar raporti “Regresi i drejtësisë civile”, i cili raport paraqet gjetjet nga monitorimi që IKD ua ka bërë rasteve gjyqësore civile gjatë vitit 2021.

Anesa Hoxha, hulumtuese në IKD, tha se ngarkesa e gjykatave me lëndë civile është si pasojë e administrimit joadekuat të institucioneve përkitazi me kontratat kolektive. Fillimisht, Hoxha ka thënë se nga monitorimi sistematik që IKD-ja i bën sistemit të drejtësisë gjatë vitit 2021 ka monitoruar gjithsej 1.166 seanca të natyrës civile prej të cilave 911 janë mbajtur, ndërsa 255 janë shtyrë e që, sipas këtyre

të dhënave, del se çdo e pesta seancë civile është shtyrë.

Ajo ka shtuar se viti 2021 është një nga vitet i cili ka shënuar rekord të ngritjes së numrit të lëndëve të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti. “Nëse e shohim kronologjikisht, që nga viti 2018 e deri në fund të vitit 2021, numri i lëndëve të pazgjidhura pothuajse është dyfishuar përderisa në vitin 2018 numri i lëndëve të pazgjidhura ka qenë 44 213, në vitin 2021 ka qenë 85 087”, ka theksuar Hoxha. Sa i përket ngarkesës së gjykatave me lëndë civile, sipas Hoxhës, faktori kryesor i kësaj dukurie është rritja eksponenciale e numrit të lëndëve të pranuar, ku gjatë vitit 2021 janë pranuar 43 536 lëndë. Ajo shtoi se shkaktri kryesor i rritjes së numrit të lëndëve të pranuar dhe i rëndimit kaq të madh të sistemit gjyqësor konsiderohet të jetë

administrimi joadekuat i institucioneve të cilat janë të obliguara që t’i përmbushin detyrimet sipas Kontratave Kolektive.

Moszbatimi i obligimeve që rrjedhin nga këto kontrata, sipas Hoxhës, ka bërë që të drejtat që rrjedhin nga këto kontrata të fitohen vetëm përmes rrugëve gjyqësore dhe kjo qasje ka rënduar tejmas gjendjen e sistemit të drejtësisë. “Vetëm gjatë vitit 2021, rreth 17 400 lëndë civile apo 40 % e lëndëve të pranuar janë lëndë të cilat rrjedhin nga kontestet që ndërlihen me zbatimin e obligimeve përkitazi me kontratën kolektive”, ka thënë Hoxha.

Përpos rëndesës së sistemit gjyqësor, ky mosveprim nga ana e institucioneve administrative, siç tha Hoxha, dëmton edhe buxhetin e Republikës së Kosovës, pasi që kur realizimi i të



drejtave që rrjedhin nga kontratat kolektive u nënshtrohet rrugëve gjyqësore, atëherë krijohen edhe shpenzimet procedurale, që në disa raste dinë të jenë më të larta sesa vetë e drejta që kërkohet. Sa i përket efikasitetit të gjyqtarëve, Hoxha tha se nëse merret si pikë reference numri i lëndëve të cilat gjyqtarët obligohen t’i zgjidhin brenda një viti, atëherë del se rritjes së

numrit të lëndëve të pazgjidhura i ka kontribuar edhe mosefikasiteti i gjyqtarëve pasi që, sipas Hoxhës, mesatarisht brenda vitit ka zgjidhur 115 lëndë më pas sesa obligimi i tyre i përcaktuar nga KGJK. Ndërsa sipas hulumtueses së IKD-së, Justina Frrokaj, një ndër sfidat e tjera të administrimit të drejtësisë civile vazhdon të mbetet kohëzgjatja e procedurave gjyqësore.

Kosovës që së bashku me kryetarin Konjufca nënshkruam. Sot diskutuam edhe për organizimin e mbledhjes së përbashkët ndërmjet dy kuvendeve në muajin nëntor në kuadër të 110-vjetorit të pavarësisë”, ka deklaruar kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë.

Nikolla, po ashtu, ka bërë me dije se teksti i rezolutës së Kuvendit të

Shqipërisë mbi pabazueshmërinë e pretendimeve për trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë dhe Shqipëri, të miratuar më 21 korrik 2022, i është përcjell zyrtarisht Këshillit të Evropës.

Duke rikonfirmuar mbështetjen për liberalizimin e vizave për Kosovën, kryetarja Nikolla tha se Kuvendi i Shqipërisë vlerëson

qëndrimet e matura dhe korrekte të institucioneve të Kosovës, si dhe përparimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare si dhe të gjitha arritjet në planin e brendshëm dhe të jashtëm.

Në bazë të memorandumit, bashkëpunimi midis dy parlamenteve do të fokusohet në fusha me interes të përbashkët strategjik, siç është bashkëpunimi

në procesin legjislativ për përafrimin e legjislacionit të dy vendeve dhe të secilit vend me legjislacionin e BE-së. Për këtë qëllim, parashihet organizimi në mënyrë periodike i Tryezës së Kryetarëve të Komisioneve Parlamentare, ku do të bashkërendohet agenda dhe veprimet mes komisioneve parlamentare për çështje me interes të përbashkët.

Gjithashtu, parashihet mbështetje në fushën e diplomacisë parlamentare dhe shkëmbimi i përvojave në fushën e edukimit qytetar e të marrëdhënieve me publikun.

Gjatë vizitës në Tiranë, Konjufca po shoqërohet nga nënkryetarët e Kuvendit, Enver Hoxhaj dhe Bekim Arifi, shefi i kabinetit, Ilir Kërçeli dhe sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi.

# Propozimi gjermano-francez, i përfaqësuar me kërkesat e Aleksandër Vuçiqit



**Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA**

**Asgjë e re që nuk ishte dëgjuar më parë:** Më në fund doli një propozim i emisarëve të kancelarit Sholc dhe presidentit Macron që më parë e dorëzuan në adresë të Albin Kurtit dhe Aleksandër Vuçiqit gjatë vizitave në Prishtinë dhe Beograd. Kishte paralajmërim se do të ishte një propozim i modeluar sipas dy gjermanive, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Realisht, ky model përfundoi me bashkimin e dy gjermanive, prandaj ishte i pranueshëm për gjermanët në ndërkohë që me këtë propozim ka të ngjarë, jo që Kosova të njihet nga Serbia si shtet i pavarur dhe sovran, përkundrazi, lehtësisht mund të përfundojë në një lidhje me Serbinë, federative apo konfederative, nuk ka shumë rëndësi. Nëse drafti i propozuar e që është bërë publik në AP është i vërtetë atëherë, me siguri, mund të thuhet se asnjë pikë e propozuar nuk është e mirë për Kosovën, nuk ofron asnjë

zgjidhje përfundimtare dhe, pa asnjë dyshim, është një zgjidhje që lirisht mund të konsiderohet si një "dhuratë e bekuar" për Serbinë aq më parë që pikërisht Serbisë dhe Aleksandër Vuçiqit i sjellë fitore përfundimtare dhe të pamohueshme, prej një situatë kur përfundimisht e ka humbur Kosovën (në qershorin e vitit 1999), realisht e mban Kosovën në një gjendje të përhershme jofunksionaliteti. Ky ishte qëllimi i Serbisë që nga fillimi e jo marrja e një pjese të Kosovës. Serbia angazhohet që veriun e Kosovës ta ketë nën kontroll e që edhe e ka dhe, në të njëjtën kohë, përmes zonave të mbrojtura dhe kishës të ushtrisë pushtet paralel në komunat që do të ishin nën sovranitetin e Zajebnicës. Ky propozim është bërë për Serbinë dhe ka të ngjarë që Serbia është bashkautorë e këtij propozimi. Franca tradicionalisht është në anën e Serbisë kurse Gjermania, në

përpjekje të marrë rol udhëheqës në Ballkan dhe Evropë, po e luan një rol oportunist kurse, që nga koha e kancelares Merkel, është rreshtuar krahas Serbisë duke e fuqizuar ekonomikisht dhe politikisht. Ishte i famshëm propozimi gjerman që pasuritë e Kosovës në veri të vendit të administrohen për një periudhë 20-vjeçare nga ndërkombëtarët (fuqitë e mëdha) e që pastaj populli (serbët e veriut) të vendosë me një referendum për ato pronat dhe me kë duan të jetojnë. Të gjitha përpjekjet e ndërkombëtarëve, thuaja pa përjashtim, janë që të formohet Zajebnica e komunave serbe (e Serbisë) në Kosovë para se të nënshkruhet një marrëveshje përfundimtare për normalizim të marrëdhënieve. Nëse Zajebnica, në këtë format e sidomos me këtë përmbajtje (me kompetenca ekzekutive apo si pushtet i tretë) do të themelohej, atëherë Kosova

do të ikë përlesh, si shtet i pavarur dhe sovran! Drafti gjermano-francez i përshtatet Serbisë dhe e dekomponon Kosovën. Është i pakrahueshëm dallimi midis dy gjermanive dhe ai midis Kosovës dhe Serbisë. Ka qenë e sigurt se Gjermania, e ndarë dhunshëm në dy shtete pas përfundimit të luftës së dytë botërore, me kalimin e kohës pashmangshëm do të bashkohet andaj ka qenë e panevojshme dhe e palogjikshme njohja reciproke midis dy (një) shteti të njëjtë në masën 100 %. Në vend të një zgjidhjeje të shpejtë dhe të imponuar ofrohet një perspektivë hipotetike që kjo mund të përfundojë në vitin 2033, nëse BE-ja do të jetë e gatshme të integrojë 6 vendet e Ballkanit. Po, nëse në ndërkohë do të dalin probleme të parashikueshme dhe të paparashikueshme, kjo mund të shtyhet deri në vitin 2043 2053 e deri në 3033. Nuk e besoj se dikush do të merret

me Kosovën në vitin 2033., përveç Serbisë. Joshjet se Kosovën do ta pranojnë 5 shtetet e mbetura të BE-së, pas një kohe janë joserioze, shantazhuese dhe se nuk ka asnjë siguri për këtë. Pranimi i Serbisë se do të luaj rol pasiv gjatë anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare është legalizim i heshtur për aktivitetet minuese që Serbia po i zhvillon tani kundër Kosovës. Nuk thuhet shprehimisht se Serbia do të sanksionohet nëse lobon (qoftë edhe në mënyrë pasive) kundër anëtarësimit të Kosovës. Përmendet anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës (Kosova ka aplikuar për anëtarësim), më vonë anëtarësimi në Interpol, shqyrtimi i mundësisë për anëtarësim në NATO, kurse anëtarësimi në OKB mbetet në mëshirën e Kinës dhe të Rusisë. Kjo është perspektiva që i ofrohet Kosovës ose, më mirë të thuhet favorët që i bëhen Serbisë me këtë

propozim kushtëzues. Ndërsa, pranimi i gjendjes ekzistuese zëvendësohet me njohjen reciproke të cilën Serbia nuk do ta bëjë, së paku në një të ardhme të afërt, 100, 300 apo 500-vjeçare!

Serbisë i ndahet posti apo detyra e kryexhandarit të Ballkanit dhe bartësit kryesor të kuletës në Ballkan. Këtë propozim në Kosovë do ta pranonte vetëm një politikan batakçi që me çdo kusht përpigjet të mbesë në pushtet ose një politikan batakçi që me çdo kusht ka për qëllim të marrë pushtetin dhe që tërë kohën ka qenë pjesë e kënetës politike, duke mbijetuar në të gjitha regjimet.

Kosova ka nevojë për një zgjidhje radikale që njëherë e mirë i ndanë rrugët me Serbinë, si kushti kryesor për normalizim të vërtetë dhe të qëndrueshëm të marrëdhënies midis dy shteteve. Çdo shtyrje e kushtëzuar vetëm sa për sy dhe faqe, jo që nuk e zgjidhë këtë problem shekullor por vetëm sa e bënë më të ndërlikuar dhe më të pazgjidhshëm. Kryeministri Albin Kurti para se ta takojë urgjentisht kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, është dashur të takojë opozitën kosovare dhe të ndërtojë një qëndrim të përbashkët për këtë propozim. Qartazi, Kurti po e shpërfillë keq opozitën dhe kjo do t'i hakmerret kur duhet të marrë vendime të vështira që po dalin nga aktgjykimi politik shantazhues i Macronit dhe Sholcin. Është e palogjikshme dhe idioteske që e njëjta letër (me të njëjtën përmbajtje) t'i dorëzohen Serbisë dhe Kosovës sepse në këtë mënyrë po barazohet përgjegjësia, si

nga e kaluara ashtu edhe kjo e sotmit. Njeriu nuk do ta bënte këtë aq më parë nëse seriozisht mendon ta bëjë një zgjidhje të drejtë dhe të qëndrueshme!

Gabimi më i madh i opozitës do të ishte nëse të ardhmen e saj politike do ta ndërtojë në situatat e vështira me të cilën do të përballlet Albin Kurti dhe qeveria që e udhëheq e sidomos nëse e merr ndonjë për rrëzimin e qeverisë Kurti 2. Premtimi se Kosovës do t'i liberalizohen vizat është joserioz dhe me afat të skaduar aq më parë që ky liberalizim kushtëzohet me nënshkrimin e marrëveshjes, nëse marrin garancione nga qeveria se do të jetë konstruktive në bisedime, liberalizohen vizat. Ky liberalizim i kushtëzuar dhe shantazhuar po ndërlikohet me afatet e Macronit dhe Sholcit në aktgjykimet që iu dorëzuan Kurtit dhe Vuçiqit, pa të drejtë apelimi. Çka të duhen vizat kur as në Pejë nuk mund të shkosh, pa e tronditur buxhetin familjar?! Dhe, në fund të fundit Gjermania dhe shtetet tjera po i japin vizat për kuadro të reja dhe profesionale kosovare sepse kanë nevojë për to, pa investuar as edhe një cent të vetëm në shkollimin e tyre. Në ndërkohë ne po importojmë kuadro intelektualisht dhe profesionalisht impotentë dhe të rrjedhur duke ua besuar përgjegjësi që as në ëndërr nuk do t'i merrnin në mend. Në mungesë të kokave të mençura duhet të llogarisim dhe shpresojmë në gabimet e Serbisë, sikur në rastin e mosnënshkrimit të Marrëveshjes në Rambuje. Mirëpo, duket se Vuçiqi ka marrë mësim nga pësimi i

Milloseviqit dhe se do ta luaj lojën: "tërhiq e mos e këput". Ndërkaq, pala kosovare e ka vështrë ta pranojë këtë propozim sikur që e ka edhe më vështirë ta refuzojë!

**Sindikalistët (s)ka kush t'i thyejë:** SBASHK-u e nisi vitin shkollor me greva, sikur edhe në vitet e mëparshme. Më herët greva përfundonte, kryesisht në favor të SBASHK-ut kurse tani, kryeministri Kurti, bashkë me kamarillën qeverisëse bëri e ç'nuk bëri për ta dobësuar dhe për ta përçarë grevën. Dhe duket se e arriti këtë qëllim. Tash, për ta ruajtur grushtin e qeverisë dhe nderin e Rrahman Jasharajt, u angazhua si ndërmjetësues Avokati i Populli për të: "larë m.. me sh..ë". Është e qartë se SBASHK-u, plumbin për derra të egër e harxhoi duke gjuajtur lepuj andaj po e paguan një çmim, dorëzimi i ndershëm para një terrori mediatik linçues të eksponentëve të qeverisë apo stalinistët - enveristët e thekur nga Tirana, Elvis Hoxha dhe Hysamedin Ferraj sikur edhe Babushka e Stalinit në Tiranë, sigurimsja Mihali. Nuk mbahet mend se dikush i ka luftuar më shumë sindikatat se qeveria aktuale e cila, e gjetur nën presion të sindikatave evropiane dhe të botës, pas reagimeve të shumta, po përpigjet të gjejë një strategji dalëse nga kjo situatë. Pas ndërprerjes së grevës do të kërkohet që Arbërie Nagavci t'ia dërgojë kokën (postin) e Rrahman Jasharajt kryeministrin Albin Kurti për ta kënduar këngën: "trupit në Pejë o Rraho, koka në Prishtinë, të prenë o të grinë o Rraho, në Gjakovë dhe Prishtinë...". Divide et impera,

përçaj dhe terrorizo është mënyra më e mirë për të vendosur rregull duke i treguar muskujt pushtetor sindikatës. Rrahman Jasharaj është dashur ta bëjë vlerësimin real të situatës para se të hyjë në grevë dhe të ketë përkrahje të plotë të anëtarësisë. Së fundi, nuk dihej kush ishte përfaqësues i vërtetë i sindikatave, Rrahman Jasharaj apo Arbërie Nagavci! Nëse Rrahman Jasharaj do ta kishte përkrahjen e plotë dhe efektive të BSPK-së, roli i Arbërie Nagavcit do të vendosej në kornizat e reales apo që e meriton, një korriere e vogël partiake, ma shall të kuq rreth qafe. Në tërë botën sindikata është për të "krijuar probleme" kurse qeveria për të zgjedhur probleme. Ndaj Rrahman Jasharaj kishte një trajtim sadist dhe mazokist nga segmente të caktuara të qeverisë. Po ta kishte quajtur brate në vend vëlla, Rrahman Jasharaj do të trajtohej më dinjitetshëm. Rrahman Jasharaj mund ta ketë ngulur një gozhdë në arkivolin e Arsimit kosovar por, Arbërie Nagavci do ta varrosë këtë arkivol - arsim, edhe pa atë gozhdën e Rrahman Jasharajt.

**Konspiracione dhe përralla në It's Kosova:** Partia e famshme Guxo mbajti Kuvendin ku u zgjodhën dy kryetarë, ka katër deputetë, një presidentë dhe 12 anëtarë që garantojnë se lirisht, deri në përfundim të mandatit do ta kalojnë pragun e Zyrës së Presidencës së Kosovës. Për zgjedhje kandidon si bisht i LV-së ndryshe, edhe pragu më i ulët për ta kapërcyer do të jetë i lartë sa Mont Everseti në Himalaje.

U përhap, pas hakimit të faqeve të Ministrisë për Punë të Brendshme të Shqipërisë, një lajm se ndaj Izet Haxhës, Xhavit Halitit dhe kryeministrin Kurti qenka bërë gati një atentat zinxhiror dhe se këtë do ta bënte një snajperist nga rrethi i Shkodrës. Pastaj doli një informatë se edhe ndaj Fatmir Limajt dhe 6 politikanëve kosovarë kishte planifikim për atentat. Prej këtyre atentateve, të gjitha kanë qenë vetëm si projekt, si ide ndërsa i vetmi atentat që ka dështuar në Kosovë e që edhe ngjau ishte sulmi me bomba mielli të tipit 500 ndaj ministrit Murati. Krejt të tjerat janë p...ë të ftohta. Xhavit Halitin po e vranë që 40 vjet dhe nëse Xhavit do t'i kishte 7 shpirtra (si macja), nuk do t'i mjaftonin të mbetej gjallë. Izet Haxhën e futën në burg më herët, kurse Albin Kurti u blindua nga rojet e shumta. Personalisht, aspak nuk besoj në këto të dhëna që janë deshifruar pas hakimit të dokumenteve të ndjeshme. Izet Haxha nuk është atraktiv për atentat, Xhavit po hyn në listën ku më parë do t'i bëhet atentat biologjik (për shkak të moshës), kurse Albin Kurtin nuk ta prekë askush, nuk ka pse! Por ne jemi të tillë, nuk merremi me gjëra të vogla, prandaj edhe kapemi për konspiracione të mëdha, jo Veton Surra është mason, jo Besnik Bislimi është inteligjent, jo grupi teknik për bisedime përbëhet nga patriotë e jo mercenarë, jo Danimarka po e pezullon marrëveshjen me Kosovën për trafikim me qenie njerëzore (me të burgosur), jo Gjeti po bëhet kryetar i Tanzanisë etj. It's Kosova, kjo është Kosova. Për fat të keq.



## PBB-ja në Kosovë arrin në rreth 8 miliardë euro

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) gjatë vitit 2021 ka arritur në 7.96 miliardë euro, ku për kokë banori është 4 486 euro, kështu thuhet në raportin "Bruto Produkti Vendor (BPV) me Qasjen e Shpenzimeve dhe të Prodhimit, viti 2021", paraqitur nga Agjencia e Statistikave e Kosovës. Sipas ASK-së, rritja reale e PBB-së për këtë vit, krahasuar me vitin 2020, ishte 10.75 për qind. "BPV me çmime aktuale në vitin 2021 ishte 7,957.8 milionë euro. Rritja reale në vitin 2021, në krahasim me vitin 2020, ishte 10.75 për qind. BPV për kokë banori për vitin 2021 ishte 4 486 euro", thuhet nga ASK-ja.

Në këtë publikim theksohet se hoteleria, tregtia dhe transporti ishin sektorët me rritjen reale më të madhe ekonomike. "Rritje reale për vitin 2021 kishte në këto aktivitete ekonomike: hotele dhe restorante me 34.7 për qind, tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i automjeteve dhe motoçikletave me 18.8 për qind, transport dhe magazinim me 14.3 për qind, industri përpunuese me 10.6 për qind, ndërtimtari me 8.8 për qind, aktivitete administrative dhe mbështetëse me 8.5 për qind, art, zbavitje dhe rekreacion me 8 për qind, aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike me 6.7 për qind, edukim me 6.6 për qind", theksohet në raportin e ASK-



së. Më tej theksohet se "aktivitete financiare dhe të sigurimit me 6.2 për qind, furnizim me ujë me 6.1 për qind, informim dhe komunikim me 4.3 për qind, industri nxjerrëse me 4.3 për qind, shërbime të tjera me 3.6

për qind, afarizëm me pasuri të patundshme me 2.5 për qind, shëndetësi dhe aktivitete të punës sociale me 1.1 për qind". Ndërsa rënie kishte në administrim publik dhe i mbrojtjes, sigurim i

detyrueshëm social me 0.9 për qind, furnizim me energji elektrike dhe me gaz me 2.1 për qind, bujqësi dhe gjueti, pylltaria dhe peshkim me 2.5 për qind.

Në anën tjetër, rritje reale sipas komponentëve kryesorë të PBB-së me qasjen e shpenzimeve për vitin 2021 ishte tek eksporti i shërbimeve me 88.8 për qind, eksporti i mallrave me 51.6 për qind, importi i shërbimeve me 44.3 për qind, importi i mallrave (FOB) me 28.8 për qind, formimi i bruto kapitalit me 10.7 për qind, shpenzimet e konsumit final të qeverisë me 9 për qind dhe shpenzimet e konsumit final me 7.5 për qind. Në fund theksohet se rënie kishte te ndryshimet në inventar me 7.9 për qind.

## Azemi paraqet një kompani amerikane, thotë se do të investojë 800 milionë euro



**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, ka bërë me dije të martën se kompania "American Exploration and Mining LLC" do të investojë 800 milionë euro në Kosovë.

Azemi në një konferencë për medie ka thënë se paga minimale do të jetë 800 euro për 5 mijë punëtorët që pritet t'i punësojë në Kosovë. "Në Kosovë kjo kompani po ofron investim prej 800 milionë eurove. Në këtë projekt në mënyrë direkte parashihen që të jenë të punësuar deri në 5

mijë persona, e që do të thotë se paga e tyre minimale do të jetë 800 euro, pra pesë herë më e lartë prej pagës që e kemi këtu", ka deklaruar ai.

Azemi ka paralajmëruar se investimi do t'i përfshijë 15 mijë punëtorë indirektë. "Përveç punëtorëve që do të kenë ndikim në mënyrë direkte,

kemi deri edhe 15 mijë punëtorë që do të jenë në mënyrë indirekte dhe paga minimale e tyre do të jetë 500 euro", ka theksuar ai.

Azemi ka treguar se kjo kompani do t'i japë 20 milionë euro për Qeverinë e Kosovës. "Kjo kompani për Qeverinë e Kosovës ka paraparë që për

Ministrinë e Inovacionit t'i japë 1 milion dollarë dhe 1 milion dollarë për Ministrinë e Infrastrukturës, gjegjësisht për rregullimin e trenave. Po ashtu, janë paraparë 20 milionë euro për ta ndihmuar Qeverinë e Kosovës", ka thënë kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, Jusuf Azemi.

## SPERTK kërkon nga Kuvendi kthimin e 2.1 milionë eurove në buxhetin e RTK-së

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Sindikata e Punëtorëve e RTK-së kërkon nga Kuvendi që në kohën kur fillojnë dëgjimet buxhetore për vitin 2023, t'ia kthejë RTK-së buxhetin prej 2.1 milionë eurove të cilat i janë hequr më herët. "Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, RTK edhe ashtu ka pasur buxhet të vogël dhe shkurtesa prej 2.1 milionë eurosh ka shkaktuar probleme të mëdha në funksionimin normal të mediumit. Si rrjedhojë, me këtë buxhet RTK

më nuk mund të funksionojë e lëre ta pasurojë skemën programore me programe të reja për shikuesit nga të cilët edhe financohemi. Kjo kërkesë është urgjente dhe kërkojmë nga themeluesi i RTK-së që ta trajtojë shumë seriozisht", thuhet në kërkesën e SPERTK-së, duke shtuar se problem tjetër që shkakton pengesa të mëdha është edhe prona e RTK-së. "Ne në kërkesa të mëhershme kemi kërkuar që objekti ku është Radio Kosova t'i takojë

ligjërisht RTK-së dhe kjo mund të bëhet nga Kuvendi i Kosovës. Të nderuar deputetë, kjo është koha e fundit për t'i adresuar këto çështje me urgjencë, sepse këto probleme e dëmtojnë edhe më shumë funksionimin dhe të ardhmen e RTK-së. Nuk ka asnjë medium publik në rajon që funksionon me kushte të tilla, pa pronë e me buxhet të shkurtuar. Besojmë në adresimin e shpejtë të këtyre çështjeve këtë vit", theksohet në kërkesën e SPERTK-së.





# I vetmi shtet evropian, që nuk po vuan nga kriza energjetike



Për shkak të luftës në Ukrainë dhe një rreziku real të ndërprerjes së furnizimeve energjetikë nga Rusia, Norvegjia është shndërruar në furnizuesen e parë me gaz të Bashkimit Evropian, që prej muajsh po përpiqet të diversifikojë burimet e furnizimit, në mënyrë që të reduktojë gjithnjë e më shumë varësinë e tij nga Rusia.

Norvegjia, një vend anëtar i NATO-s, por jo i Bashkimit Evropian, ka arritur të rrisë me shpejtësi prodhimin dhe të plotësojë një nevojë në rritje për zëvendësimin e gazit rus. Dhe për momentin por arkëton fitime të mëdha. Norvegjia është eksportuesja e shtatë më e madhe e naftës në botë, dhe e katërta më e madhe e gazit.

Sipas të dhënave nga instituti statistikor norvegjez, në 8 muajt e parë të këtij viti eksportet e gazit arritën vlerën e 775 miliardë koronave norvegjeze, rreth 77 miliardë euro, ose 315 për qind më shumë se sa në të njëjtën periudhë të vitit 2021. Në muajin gusht, eksportet e gazit arritën

maksimumin e tyre historik: 176 miliardë korona norvegjeze, ose 17 miliardë euro, gati 40 për qind më shumë se një muaj më parë, dhe 360 për qind më shumë se në gushtin e vitit 2021.

Në vitin 2021, Norvegjia eksportoi afro 113 miliardë metra kub gaz në Bashkimin Evropian dhe ishte furnizuesja e dytë pas Ruisë, e cila shiti 155 miliardë metra kub. Ndërkohë që nga fillimi i luftës në Ukrainë, ajo është bërë furnizuesja më e madhe e Bashkimit Evropian.

Që nga fillimi i vitit, Oslo ka eksportuar gaz për një vlerë prej 60 miliardë eurosh, pothuajse 80 për qind të të gjithë eksporteve të gazit, dhe 304 për qind më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Por Norvegjia shtoi jo vetëm vëllimin e shitjeve, por ka përfutur edhe nga çmimet teje të larta të lëndëve të para.

Në gusht, fitimet e saj ishin më shumë se 4 herë më të larta se në vitin 2021, krahasuar me vëllimet e shitjeve, që u rritën me

vetëm 12.8 për qind. Qeveria norvegjeze parashikon se të ardhurat e nga nafta dhe gazi do të arrijnë në 100 miliardë euro këtë vit, një shifër kjo e jashtëzakonshme.

Po ashtu janë rritur edhe eksportet e naftës. Që nga fillimi i vitit, Norvegjia ka eksportuar 35 miliardë euro naftë, ose 61 për qind më shumë se vitin e kaluar. Duke pasur parasysh perspektivat e larta të fitimeve, Norvegjia pret që të ruajë nivelet aktuale të prodhimit të gazit deri në vitin 2030, njoftoi Ministri norvegjez i Energjisë, Terje Aasland, në fundin e muajit gusht raporton bota.al.


Reduktimi i mëtejshëm i gazit rus në Bashkimin Evropian javët e fundit, e ka bërë këtë vend thelbësor për furnizimin e kontinentit Aq sa Komisioneri Evropian për Energjinë, Kadri Simson, deklaroi një konferencë për shtyp se së bashku me Norvegjinë po përpiqen të krijojnë një linjë të qëndrueshme dhe në rritje të furnizimit, duke kërkuar në këmbim që vendet e BE-së ta blejnë lëndën e parë me një çmim më të

ulët, në krahasim me atë të tregut.

Kjo dinamikë ka nxjerrë më në pah një paradoks që në fakt ekziston prej vitesh. Norvegjia po pasurohet falë eksporteve të lëndëve djegëse fosile, ndërkohë që është një nga vendet më të përparuara sa i përket burimeve të rinovueshme.

Por kriza energjetike në Bashkimin Evropian, e ka shtuar presionin që Norvegjia të rrisë më tej prodhimin e gazit dhe naftës, me kërkime të reja edhe në zona të ndjeshme, të kontestuara nga ambientalistët, si në Detin Barents. Kjo dilemë ka pasojë në debatin e brendshëm politik, që u shfaq edhe në fushatën elektorale të vitit 2021.

Në realitet, përveç të Gjëlberve dhe të Majtës Socialiste, asnjë nga partitë kryesore nuk kërkoi që t'i jepet fund eksplorimeve për burime të reja, si për shkak të pasojave të mundshme tek punësimi, por edhe sepse të ardhurat nga gazi dhe nafta mund të financojnë zhvillimin e energjisë së pastër në vend. / "Il Post" – Bota.al



## Kosova ka mungesa, por Giresse pret paraqitje të mira

**PRISHTINË, 20 SHTATOR** - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Alain Giresse, në konferencë ka shprehur shqetësimet e tij për lëndimin e tre futbollistëve në prag të dy ndeshjeve të shtatorit kundër Irlandës së Veriut dhe Qipros. Trajneri francez ka theksuar se lëndimi i dy mbrojtësve, Mërgim Vojova e Leart Paqarada, si dhe sulmuesi Shkëlqim Vladi, është dëshpërues, sidomos duke pasur parasysh faktin që në repartin defensiv është më e vështirë për t'i gjetur zëvendësimet adekuate për shkak të mungesës së përvojës së lojtarëve të tillë në arenën ndërkombëtare. "Lista fillestare ka qenë në 26 lojtarë, pastaj është reduktuar në 23 lojtarë shkaku i lëndimeve. Do të shikojmë cila është mënyra më e mirë për t'i zëvendësuar këta lojtarë. Kjo është arsyeja pse nuk jap emra konkretë, sepse në disa

pozita kemi lojtarë më pak se në disa pozita të tjera. Për dallim me pjesën ofensive, ku në rast lëndimesh është më lehtë të bëhen zëvendësime, në defensivë është pak më vështirë, sidomos në krahun e majtë, siç është rasti i mungesës së Leart Paqaradës, sepse kemi më pak lojtarë që kanë përvojë ndërkombëtare që luajnë në këto pozita. Kur mungon përvoja është pak më problematik zëvendësimi", ka theksuar Giresse.

Sa iu përket ndeshjeve kundër Irlandës së Veriut dhe Qipros, Giresse ka thënë se mënyra e paraqitjes së Kosovës do të varet nga rivalët, por ka thënë se do të jetë i detyruar të bëjë ndryshime për shkak të mungesave. "Ne do të rreshtohemi në mënyrën më të mirë të mundshme. Por, pa dyshim që do të ketë ndryshime nga ndeshjet e kaluara sepse



kemi mungesa në ekip", është shprehur Giresse. Ai e ka vlerësuar shumë pozitiv faktin që Ballkani luan në fazën e grupeve të Ligës së Konferencës, teksa ka thënë se sukseset e ekipeve kosovare në garat evropiane në vitet e fundit nga Ballkani, Drita e Llapi, kanë bërë që në këtë grumbullim të kemi tre lojtarë nga Superliga në ekipin përfaqësues.

Giresse ka thënë se pikërisht nga futbollit kosovar kanë dalë lojtarë si Muriqi, Rashica e Zhegrova. Paraprakisht, "dardanët" e kanë mbajtur seancën e radhës stërvitore në Kampin Nacional në Hajvali, ku njëri grup i lojtarëve ka punuar me intensitet, teksa disa prej lojtarëve që kanë arritur gjatë ditës së djeshme në grumbullim kanë stërvitur të diferencuar, me vrapime të lehta dhe lojë me top pa ngarkesë.

## Ylli sonte debutoon në Ligën e Kampionëve, përballet me Benficën



Suharekë, 20 shtator - Golden Eagle Ylli për herë të parë do të luajë në garat ndërkombëtare, ndërsa do të debutojë në Ligën e Kampionëve, përkatësisht në kualifikimet e kësaj radhe. Kampionët e Kosovës do të përballen me Benficën e Lisbonës, ndeshje që do të zhvillohet në Portugali, të mërkurën, më 21 shtator, me fillim nga ora 22:00, sipas kohës sonë lokale. Ndeshjet

çerekfinale do të zhvillohen më 21 shtator, dy ditë më pas (23 shtator) zhvillohen gjysmëfinale dhe më 25 shtator finalja.

Fituesi i ndeshjes Golden Eagle Ylli - Benfica do të ndeshet me skuadrën qipriote, Keravnos. Ndërsa fituesi i gjysmëfinale Ylli/Benfica - Keravnos do të luajë në finalen kualifikuese me fituesin e gjysmëfinale Budivelnik/Norrköping -

Bamberg. Katër skuadrat nga kjo fazë do t'u bashkohen 28 skuadrave për t'u formuar kështu 32 skuadrat që do të garojnë në edicionin e ri të kësaj gare. Nëse Ylli nuk arrin në grupet e Ligës së Kampionëve, atëherë do të kualifikohet në grupet e FIBA Europe Cup. Therandasit janë kampionë të Kosovës në dy vitet e fundit, ndërsa një herë e kanë fituar Ligën Unike dhe Superkupën Mbarëkombëtare.

## Federata e Golfit e Kosovës ka aplikuar për t'u bërë pjesë e Federatës Evropiane

**PRISHTINË, 20 SHTATOR** - Federata e Golfit e Kosovës edhe zyrtarisht ka aplikuar që të bëhet pjesë e Federatës Evropiane të Golfit dhe pret që kjo të arrihet pas dy muajve. Lajmin e ka dhënë nënkryetari i kësaj federate, Lavdim Zylfiu, në një konferencë për medie, duke deklaruar se është shumë optimistë se kjo edhe do të arrihet. "Ju informojmë se Federata e Golfit e Kosovës do ta organizojë kampionatin e radhës, kampionatin e tretë shtetëror të golfit me datë 30 shtator në resorin e golfit në Gjermani në të cilin do të marrin pjesë 55 lojtarë të golfit të cilët do të udhëtojnë 10 shtete të ndryshme të botës dhe në këtë kampionat do t'i kemi

pesë lojtare femra të kualitetit jashtëzakonisht të lartë. Ky kampionat me kënaqësinë më të madhe ju informoj se do t'i paraprijë anëtarësimit të Federatës së Golfit të Kosovës në European Golf Association, e njohur si EGA, e që është organizata më kulminante e golfit në kontinentin e vjetër. Ne si federatë zyrtarisht kemi aplikuar dje për t'u bërë anëtarë më i ri në EGA dhe aplikimet i kemi marrë dy javë më herët në një bashkëbisedim dhe bashkërendim të aktivitetit së bashku me zyrtarët e EGA-s", ka thënë Zylfiu, i cili më pas ka zbuluar edhe hollësi të tjera, duke thënë se tani e tutje kjo federatë do ta ketë himnin e saj në garat

ndërkombëtare i cili do të intonohet para ndeshjeve si dhe është prezantuar edhe fanella e re e skuadrës. "Pas 60-ditësh pritët që të mbahet kongresi i madh i EGA-së në Lozanë të Zvicrës ku besoj se do të jemi prezent dhe ne jemi optimistë që Kosova me shumicë votash do të bëhet anëtarja më e ri e Federatës Evropiane të Golfit. Në këtë kampionat i kemi paraprirë për këtë vit edhe disa detaje shtesë. Për herë të parë do të intonohet himni i Federatës së Golfit të Kosovës me datë 30 shtator, një himn që besoj do ta keni rastin ta dëgjoni pas kampionati... Përveç kësaj, reprezentuesit e Kosovës për herë të parë këtë vit do të paraqiten në kampionatin e



Kosovës me ndërresat e saj zyrtare. Nga viti i ardhshëm për herë të parë Federata e Golfit e Kosovës, përkatësisht Republika e Kosovës, do të zhvillojë gara zyrtare në sportin e golfit, ku do të ballafaqohet fillimisht me të gjitha shtetet e rajonit dhe me shtetet e

tjera evropiane", ka shtuar Zylfiu. Ai është shprehur se kjo federatë ka buxhet të mjaftueshëm për të marrë pjesë në garat ndërkombëtare edhe pse procesi i rilicencimit po paraqet disa pengesa të vogla në mbarëvajtjen e aktiviteteve të saj.

## Fitore për 15 sezone resht, Hamiltoni synon ta thyejë rekordin e Schumacherit

LONDËR, 20 SHTATOR - Piloti britanik Lewis Hamilton nuk ka korrur ende asnjë fitore këtë sezon, ndërkohë që shpreson ta realizojë këtë në një nga garat e mbetura. Ai ndan me Michael Schumacherin dy rekorde, atë të 7 titujve kampionë

bote në Formula 1 si dhe një fitore të paktën në një garë për 15 sezone radhazi (2007-2021 Hamilton dhe 1992-2006 Schumacher). Hamiltoni shpreson që të fitojë një garë dhe të marrë këtë rekord edhe pse piloti i Mercedesit shprehet se për të

kjo nuk ka shumë rëndësi. "Do të ishte diçka e bukur nëse do të fitonim një garë. Shpresojmë. Gjithsesi, për sa i përket rekordit, ai nuk ka shumë rëndësi për mua", ka thënë Hamiltoni. "Jam krenar që nga viti 2007 kam fituar gjithnjë. Mendoj se edhe këtë

vit do ta kemi këtë mundësi, pasi ende ka gara. Nga gara në garë makina është më e shpejtë dhe ne synojmë që të jemi sërish më të mirët. Duam të luftojmë sërish për titullin. Kjo është në AND-në tonë", ka deklaruar Hamiltoni.



## Gjasula, Rejës: Nëse nevojitet luaj edhe në mbrojtje

TRANË, 20 SHTATOR - Dy ndeshje mjaft të rëndësishme, ku nevojiten 6 pikët e plota për ta përmbushur objektivin: kreun e grupit të Ligës së Kombeve. Mision i vështirë, edhe për shkak të mungesave të rëndësishme në radhët e kuqezinjve për transfertën ndaj Izraelit më 24 shtator dhe duelin me Islandën, pas tri ditësh, në "Arena Kombëtare". Duke folur në konferencën për shtyp, Klaus Gjasula u "vetofrua" për të luajtur edhe në mbrojtje, nëse trajneri Reja ka nevojë, meqë Kumbulla dhe Gjimshti janë të lënduar. "Besoj se kemi treguar se dimë të fitojmë. Këto dy ndeshje janë mjaft të rëndësishme. Le të jemi optimistë për tri pikët ndaj Izraelit si fillim. Ne kemi mungesa, por edhe kundërshtari ka problemet e veta. Izraeli ka ndryshuar shumë gjëra, ne kemi kualitet për të fituar. Është vështirë të themi që sa mirë që Izraeli ka mungesa, sepse nuk e dimë si do të luajë pa të pamundurit dhe kush do të aktivizohet në vend të tyre. Ne duam ta bëjmë maksimumin duke



parë vetëm veten tonë", ka thënë Gjasula. "Roli në fushë? E dimë që është e rëndësishme, i dimë rregullat dhe çfarë mund të arrijmë me këto gjashtë pikë. Kemi Izraelin si fillim, të përqendrohemi vetëm aty. Te klubi im, trajneri më ktheu në mbrojtje dhe nuk jam larguar nga ai pozicion. Nuk e di sesi

trajneri Reja i ka planet për mua në kombëtare. Dështim pa 6 pikët në këto dy ndeshje? Edhe ekipet e tjera janë të mira, jemi në një nivel. Ne duam t'i fitojmë të dyja ndeshjet e fundit, do ta japim maksimumin dhe të shohim se çfarë do të ndodhë", ka deklaruar Gjasula.

## Xhaka: Kurrë nuk e kam besuar se tifozët do të më këndojnë përsëri

LONDËR, 20 SHTATOR - Granit Xhaka ishte plot krenari kur mbajti sërish shiritin e kapitenit në fitoren e Arsenalit ndaj Brentfordit të dielën. 29-vjeçarit iu besua shiriti i kapitenit në mungesë të kapitenit të lënduar Martin Odegaard dhe ai udhëhoqi skuadrën në mënyrë shembullore me një paraqitje dominuese, duke i kthyer "topçinjtë" në krye të renditjes. "Kurrë, kurrë nuk e kisha menduar se kjo do të ndodhte. Të jesh përballë tyre [tifozëve udhëtues] ishte shumë emocionuese. Absolutisht, pas asaj që ndodhi tri vjet më parë? Të jesh në krye këtij ekipi do të thotë shumë për mua", ka thënë Xhaka pasi dëgjoi emrin e tij të këndohej pas ndeshjes nga tifozët. Triumfi i fundit i Arsenalit ndaj Brentfordit bëri që të shkojnë në gjashtë fitore në shtatë ndeshje në kampionat,



duke i futur në mesin e skuadrave që e duan titullin. "Nëse jam i sinqertë, duhet të kënaqemi aty ku jemi. Unë mendoj se ne gjithmonë prodhojmë një lojë të

mirë kundër Tottenhamit. Do të jetë një lojë ndryshe sepse është derbi. Ju nuk mund ta krahasoni derbin me një lojë normale", ka shtuar Xhaka.

### SHKURT

#### KV Peja mëson kundërshtarin në Kupën Ballkanike

Kampionia e Superligës dhe Kupës së Kosovës në Volejbol, KV Peja, ka mësuar kundërshtarin në Kupën Ballkanike, e cila do të zhvillohet në Turqi mes datave 20-21 shtator. Djelmohat pejanë do të përballen me ekipin e Cizre Belediye Sports Club të mërkurën me fillim nga ora 13:00. Në takimin tjetër Cizre Belediye Sports Club do të ndeshet me ekipin nga Moldavia, Dor Chisina, të martën.

#### Sermaxhaj emërohet trajner i Malishevës

Skuadra e Malishevës ka konfirmuar arritjen e marrëveshjes me Sami Sermaxhaj, i cili do të jetë trajner i ri i kësaj skuadre. "Kemi kënaqësinë të konfirmojmë se klubi ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me trajnerin Sami Sermaxhaj", thuhet në njoftimin e kësaj skuadre. Trajneri Sermaxhaj zë vendin e Arsim Thaçit, i cili u shkarkua nga posti në javën e kaluar, pas asaj që u cilësua si "një fushatë kryesisht zhgënjyese për klubin këtë sezon".

#### Lewandowski: Te Barça fitohet më lehtë 'Topi i Artë'

Sulmuesi Robert Lewandowski duhet ta kishte një "Top të Artë" në vitin 2020, pas sezonit fantastik me Bayern Munchenin. Atë vit trofeu nuk u dha prej pandemisë, ndërsa vitin pasardhës Messi e mori para sulmuesit që ishte me "bavarezët". Lewandowski ka dhënë së fundmi një intervistë dhe me siguri nuk do të pëlqehet nga tifozët e Bayernit. "Te Barcelona e fitonin shumë lojtarë, por 'Topi i Artë' s'më lë pa gjumë. Mendoj se te Barcelona ka një rrugë më të shkurtër për të ky çmim sesa te Bayerni", ka thënë Lewandowski.

#### Reusi nuk e rrezikon pjesëmarrjen në Kampionatin Botëror

Marco Reus i trembi të gjithë në fundjavë, teksa pësoi një lëndim. Për sulmuesin gjerman vijnë lajme të mira, teksa drejtori sportiv i Borussia Dortmundit, Sebastian Kehl, ka deklaruar se futbollisti do të jetë jashtë fushave vetëm 2-3 javë. "Ai ka një lëndim në ligamentin e jashtëm, duhet të ndalojë për rreth 3-4 javë. Për momentin Kupa e Botës nuk është në rrezik", ka thënë Kehl. Fillimisht u mendua se Reus rrezikon praninë në Botërorin e Katarit, por duket se gjërat nuk janë aq serioze për yllin e Gjermanisë, me tifozët që tashmë mund të marrin frymë lirisht.

## Serena Williams: Ende nuk kam thënë lamtumirë

Vetëm pak ditë pasi u eliminua mes lotësh nga grand slami i US Openit, ku dhe vendosi të mos luajë më tenis, duket se Serena Williams ka ndërruar mendje. "Ndoshta rikthehem", ka qenë

deklarata e dhënë nga tenistja 40-vjeçare amerikane. "Nuk e kam përmendur kurrë fjalën lamtumirë", u shpreh tenistja amerikane gjatë emisionit televiziv "Jimmy Fallon Night Show" ku ishte e

ftuar. Deklaratë të lehtë mendosh se ajo mund të rikthehet në fushat e tenisit. Ajo ka hedhur paralele me atë që bëri ikona e NFL, Tom Brady, që u rikthye vetëm pak ditësh pasi deklaroi

tërheqjen. "Jam shumë e lumtur me atë që po përjetoj. Ka shumë gjëra që nuk i kam bërë dhe dua t'i realizoj tani", ka deklaruar Serena. "Thjesht dua të shijoj ato që nuk kam pasur mundësi t'i shijoj deri

më tani. Kam folur me Tom Brady dhe asnjëherë nuk i dihet në jetë. Nuk e shoh veten larg tenisit. Dua të bëj diçka, por nuk e di se çfarë. Dua ta mbaj pranë këtë sport", ka shtuar Serena Williams.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1374/1  
Dt: 20.09.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## SHPLLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendit të lirë në Qendër e Kompetencës "11 Marsi", në Prizren dhe Qendrën e Kompetencës në Skenderaj për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
QeK	Qendra e Kompetencës "11 Marsi"	Prizren	Një mësimdhënës/e për lëndët e Elektroteknikës me 20 orë mësimore	Deri më 31.08.2023
QeK	Qendra e Kompetencës "11 Marsi"	Prizren	Një mësimdhënës/e për lëndët e Elektroteknikës me 20 orë mësimore	Deri më 31.08.2023
QeK	Qendra e Kompetencës "11 Marsi"	Prizren	Një mësimdhënës/e për lëndët e Shkencave kompjuterike dhe teknologji komunikimi me 20 orë mësimore	Deri më 31.08.2023

QeK	Qendra e Kompetencës "11 Marsi"	Prizren	Një mësimdhënës/e për lëndët e Shkencave kompjuterike dhe teknologji komunikimi me 20 orë mësimore	Deri më 31.08.2023
QeK	Qendra e Kompetencës "11 Marsi"	Prizren	Një mësimdhënës/e për lëndën e Gjuhës Angleze me 20 orë mësimore	(zëvendësim i mësimdhënësve në pushim të lehonisë)
QeK	Qendra e Kompetencës "11 Marsi"	Prizren	Një mësimdhënës/e për lëndën e Gjuhës Gjermane me 11 orë mësimore	Deri më 31.08.2023
QeK	Qendra e Kompetencës "11 Marsi"	Prizren	Një Instruktur/e për profilin Metalpunues – Saldues 20 orë mësimore	Deri më 31.08.2023
QeK	Qendra e Kompetencës "11 Marsi"	Prizren	Një (1) Punëtor teknikë/e normë e plotë,	Vend i lirë
QeK	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Një mësimdhënës/e për profilin e Arkitekturës me 20 orë mësimore	(zëvendësim i mësimdhënësve në pushim të lehonisë)

### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.

- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

### Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktur:

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e teorisë dhe praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 6 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës së punës;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

### Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore për pozitën punëtor teknik

- Bën mirëmbajtjen e pastërtisë së gjithë objektit;
- Ndihmon stafin për rregullimin e orëdivë të shkollës;
- Ndihmon menaxhmentin/personelin mësimdhënës të shkollës për realizimin e punëve teknike;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore.
- Merr pjesë në rregullimin e hapësirave të jashtme shkollore, si dhe detyra shtese të cilat i ndan drejtori i shkollës.

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Kandidati duhet të ketë Shkollën e mesme,
- Ai ose ajo duhet të jenë gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe
- Shkallë të lartë integriteti,

### Aftësitë shtesë

- Entuziazëm dhe përkushtim personal në mënyrë që të jetë i dobishëm për institucionin,
- Plotësisht i besueshëm ndaj institucionit, objektivave dhe synimeve të stafit drejtues si dhe personelit të Shkollës.

Paga: koef 4

Kontrata: Kohëzgjatja e periudhës provuese është gjashtë (6) muaj

Orari: 40 orë pune në javë

### Procedurat e konkurrimit:

- Afati i konkurrimit është 15 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucionit në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës "11 Marsi", në Prizren dhe Qendrën e Kompetencës në Skenderaj.
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.
- Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION



Nr:1375/1  
Dt. 20.09.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr. 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ (MPMS) 07/2017, Udhëzimit Administrativ (MASHT) 07/2017, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur si dhe në bazë të kërkesës së shkollës shpall:

### KONKURS

#### Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj dhe në paralelet e ndara në Mitrovicë dhe Prizren për pozitën mësimdhënës/e dhe instruktor/e për nivelin 5 të kualifikimit "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore"

Në kontekstin e reformave të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (AAP) në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka zhvilluar nivelin e 5 (pestë) të kualifikimit "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore". Qendra e Kompetencës (QeK) në Ferizaj është e akredituar nga Institucioni prestigjioz britanik PEARSON për të ofruar kualifikimin "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore". Për këtë gjeneratë kualifikim "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore" do të ofrohet në Qendrën e Kompetencës (QeK) - "Ferizaj" - dhe në paralelet e ndara: Qendrën Burimore "Përparimi" - Prishtinë, Qendrën e Kompetencës "Shtjefën Gjeqovi" - Prishtinë, Qendrën Burimore "Lef Nosi" - Prizren, dhe Qendrën Burimore "Nëna Terezë - Mitrovicë". Qendra e Kompetencës (QeK) në Ferizaj menaxhohet nga Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur.

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita	Vend i lirë
SHML	Qendra e Kompetencës Ferizaj	Mitrovicë	1 (një) Mësimdhënës/e me gjysmë norme (10 orë) për kualifikimin "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore" 1 (një) Instruktor/e me gjysmë norme (10 orë) për kualifikimin "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore"	Vend i lirë për një (1) vit shkollor
SHML	Qendra e Kompetencës Ferizaj	Prizren	1 (një) Mësimdhënës/e me gjysmë norme (10 orë) për kualifikimin "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore" 1 (një) Instruktor/e me gjysmë norme (10 orë) për kualifikimin "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore"	Vend i lirë për një (1) vit shkollor
SHML	Qendra e Kompetencës Ferizaj	Ferizaj	1 (një) Mësimdhënës/e me gjysmë norme (10 orë) për kualifikimin "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore" 1 (një) Instruktor/e me gjysmë norme (10 orë) për kualifikimin "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore"	Vend i lirë për një (1) vit shkollor

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënësit e nivelit të V-të arsimit

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës;
- Implementon programin e këtij kualifikimi duke respektuar plotësisht standardet BTEC;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me standartin e profesionit dhe programin mësimor;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi;
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës së Kompetencës dhe AAAPARr-së;
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore tënxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve;
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të kandidatëve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës;
- Merr pjesë në trajnime shtesë të kërkuara nga Qendra e Kompetencës dhe AAAPARr, përfshirë projektet e financuara nga donatorët;
- Ta përditësojë dhe ta përmirësojë në vazhdimësi pakon e materialeve ekzistuese mësimore, dhe të zhvillojë materiale të reja sipas nevojës;
- Mbështet dhe udhëzon kandidatët për realizimin e praktikës profesionale, monitoron dhe mbikëqyrë realizimin e praktikës profesionale;
- Kontribuon në aktivitetet e përgjithshme të monitorimit dhe vlerësimit në Qendrën e Kompetencës;

- Bënë hulumtime specifike për fushën/kualifikimin më qëllim të ngritjes së cilësisë dhe transferimit të njohurive dhe shkathtësive adekuate te kandidatët;
- Kontribuon në zhvillimin e praktikës profesionale duke kontaktuar organizata që mund të konsiderohen si partner potencial, në të cilat mund të organizohet praktika profesionale për kandidatët, nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e stafit drejtues të Qendrës së Kompetencës;
- Të bashkëpunojë rregullisht me organin drejtues të Qendrës së Kompetencës dhe akterët përkatës, në mënyrë që t'i realizojë marrëveshjet formale të bashkëpunimit me partnerët e organizatës duke përdorur veprat adekuate juridike për t'i arritur qëllimet e synuara;
- Të përcjellë në vazhdimësi zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive të parapara që duhet të fitohen nga kandidatët gjatë praktikës profesionale. Duke pasur parasysh këtë, duhet të krijohet një raport individual për secilin kandidat ku arsyetohen njohuritë dhe shkathtësitë e fituara gjatë praktikës profesionale, si dhe ndërlidhjen e tyre me materialet mësimore.

#### Kualifikimi dhe dokumentacioni i kërkuara për pozitën mësimdhënës/e:

- Diploma e nivelit të 7 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), drejtimet: Master për Arsim gjithëpërfshirës, Master për Edukim të fëmijëve me nevoja të veçanta ose kualifikim i përafërt;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Të këtë shkathtësi teorike dhe praktike për profesionin e caktuar;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në kushtet të barabarta, përparësi do të kenë kandidatët të cilët janë certifikuar nga PEARSON ose kandidatët e diplomuar në këtë kualifikim;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt.

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktorin e nivelit të V-të arsimit

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e teorisë dhe praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës së Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.
- Implementon programin e këtij kualifikimi duke respektuar plotësisht standardet BTEC;
- Merr pjesë në trajnime shtesë të kërkuara nga Qendra e Kompetencës dhe AAAPARr, përfshirë projektet e financuara nga donatorët;
- Ta përditësojë dhe ta përmirësojë në vazhdimësi pakon e materialeve ekzistuese mësimore, dhe të zhvillojë materiale të reja sipas nevojës;
- Mbështet dhe udhëzon kandidatët për realizimin e praktikës profesionale, monitoron dhe mbikëqyrë realizimin e praktikës profesionale;
- Kontribuon në zhvillimin e praktikës profesionale duke kontaktuar organizata që mund të konsiderohen si partner potencial, në të cilat mund të organizohet praktika profesionale për kandidatët, nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e stafit drejtues të Qendrës së Kompetencës;
- Të përcjellë në vazhdimësi zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive të parapara që duhet të fitohen nga kandidatët gjatë praktikës profesionale. Duke pasur parasysh këtë, duhet të krijohet një raport individual për secilin kandidat ku arsyetohen njohuritë dhe shkathtësitë e fituara gjatë praktikës profesionale, si dhe ndërlidhjen e tyre me materialet mësimore.

#### Kualifikimi dhe dokumentacioni i kërkuara për pozitën Instruktor/e:

- Diploma e nivelit 6 (bachelor) ose më lartë (ose instruktor profesional me kualifikim postsekondar) sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), drejtimet: Bachelor ose nivel postsekondar për Arsim gjithëpërfshirës, Bachelor ose nivel post sekondar për Edukim të fëmijëve me nevoja të veçanta ose kualifikim i përafërt;
- 5 vite përvojë pune në profesion, ndërmarrje, biznes dhe në institucione tjera
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës;
- Të këtë shkathtësi teorike dhe praktike për profesionin e caktuar;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në kushtet të barabarta, përparësi do të kenë kandidatët të cilët janë certifikuar nga PEARSON ose kandidatët e diplomuar në këtë kualifikim;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt.

#### Aftësitë shtesë


- Nivel të lartë të shkathtësive të komunikimit dhe bashkëpunimit;
- Entuziazëm dhe përkushtim personal në mënyrë që të jetë i dobishëm në zhvillimin e institucionit me cilësi të lartë dhe ndërlidhje me tregun e punës;
- Të jetë mendje-hapur në ide dhe propozime në fushën e AAP-së, gjithashtu të tregojë aftësi kreative/innovative dhe të ketë qasje të qartë për të ardhmen;
- Shkathtësi themelore kompjuterike dhe kapacitete për t'ia përshtatur në mënyrë sa më të lehtë përdorimin e veglave të TI dhe sistemet e informimit.

#### Procedurat e konkurrimit

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacioni dhe dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen (në zyrat e Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, ndërtesa MASHTI-II pranë Fakultetit Ekonomik dhe Juridik- kati i III-të, Rr. Agim Ramadani p. n, Prishtinë. Aplikacionet duhet t'i bashkëngjiten, CV-ja, kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës. Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Në rast të numrit të madh të kërkesave do të ftohen vetëm kandidatët e listës së ngushtë. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 20.09.2022  
009/2022

Referenca: AAPSK -

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	BMW, model 318 I, viti i prodhimit 1999, benzin, ngjyre e kuqe, me targa vendore	1 copë	2,200.00€		
2	Mercedes model 124, viti i prodhimit 1991, dizel, ngjyre e kuqe metalike me targa vendore	1 copë	850.00€		
3	Opel Vectra C22, viti i prodhimit 2002, benzin, ngjyre e hirit metalike, - për skrap	1 copë për skrap	336.95€		
4	Audi B4, TDI viti i prodhimit 1992, dizel, ngjyre e kuqe me targa vendore	1 copë	500.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më 27.09.2022 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë.

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 27.09.2022, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se ,në: <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Sektori i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 051.

PËR SIGURINË E JUAJ DHE PUNONJËSVE TANË, JU LUSIM QË GJATË PJESËMARRJES NË ANKAND TË MBANI MASKËN KUNDËR COVID19; MBANI DISTANCËN DHE DEZINFEKTONI DUART RREGULLISHT!

**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898  
Sallon Depilimi Lumë's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553  
PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Blend Kastrati shpall të pavlefshme dëftesat e kl. Së dhjetë, njëmbëdhjetë, dym,bëdhjetë të Gjimnazit "Sami Frashëri" Prishtinë.

- Diana Brovina shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Sami Frashëri".

- Saranda Preniqi shpall të pavlefshme dokumentet e shkollës së mesme "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Edonis Gashi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. së dhjetë të shkollës së mesme profesional "Prek Jakova" Prishtinë.

- Dr. Qamile Morina shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës me nr: KO-00549-01-01.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

